



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:158127

Datë: 24.10.2023

Numri i dokumentit: 04823273

P.nr.2806/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurës E.G., me vendbanim në fshatin ..., Komuna e, me numër personal, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - PP.II.nr.4160/23 të datës 31.07.2023, për veprën penale – Sulmi, nga neni 184 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me Marrëveshjen për Ndërmjetësim me shifrën ND.632/2023 të datës 19.10.2023, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të të pandehurës E.G. dhe të dëmtuarës V.G., konform nenit 357 par.1.3 të KPPRK-së lidhur me nenin 14 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datë 24.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET Marrëveshja për Ndërmjetësim me shifrën ND.632/2023 të datës 19.10.2023, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të të pandehurës E.G. në njërin anë dhe të dëmtuarës V.G. në anën tjetër.

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4160/23 e datës 31.07.2023 dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurës E.G., për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 184 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4160/23 më datën 31.07.2023, kundër të pandehurës E.G., për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 184 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Në seancën e datës 17.10.2023, e pandehura dhe pala e dëmtuar kanë shprehur gatishmërinë dhe vullnetin e tyre për referimin e lëndës në ndërmjetësim. Gjykata ka kërkuar edhe mendimin e Prokurores së Shtetit Zana Sadiku Sertolli, e cila duke vlerësuar se plotësohen kushtet ligjore për ndërmjetësim, është pajtuar me propozimin e palëve.

Pas propozimit të palëve, duke vepruar konform nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos që lënda të dërgohet në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Me datë 19.10.2023 në Zyrën për Ndërmjetësim në Prishtinë është arritur marrëveshja ND.618/2023, në mes të palës së dëmtuar dhe të pandehurës.

Gjykata vlerësoi se marrëveshja për ndërmjetësim pasqyron vullnetin e lirë të palëve dhe është e lidhur në pajtim me ligjin andaj duke vepruar në pajtim me nenin 15 par.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësim nr. 06/L-009, me datë 24.10.2023 e aprovoi këtë marrëveshje, e cila pas aprovimit nga Gjykata, përkatësisht nga data 24.10.2023 kjo marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 454 par. 1 të KPPRK-së.

Nga se u tha më lartë konform nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPPRK-së lidhur me neni 15.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
P.nr.2806/23, datë 24.10.2023

Gj y q t a r i

Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar Ankesa.